



**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists**

**FTESË PËR OFERTIM: AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE (BURIMI DHE
PËRDORIMI I MJETEVE).**

OFTK fton Kompanitë audituese dhe auditorët që të ofertojnë për të kryer shërbimet e Auditimit sipas IFRS dhe Standardeve ndërkombëtare të auditimit

Data e njoftimit: 06.05.2026

Data e fundit për dorëzimit të ofertave: 07.06.2026

Data e përzgjedhjes: 10.06.2026

Data e përfundimit: 01.07.2026

Objekti i kontratës: Marrëveshje e shërbimit.

**Autoriteti kontraktues: Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës
(OFTK)**

➤ **HYRJE**

Përshkrimi i programit

Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK) është themeluar si organizatë profesionale me Ligjin e miratuar në vitin 2013. OFTK përfaqëson interesin e anëtarëve të saj, fizioterapeutëve të Kosovës.

OFTK ka tre burime kryesore të të hyrave:

- të hyrat nga anëtarësia;
- taksa për licencim dhe rilicencim si dhe lartësia e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve të tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare.
- donacione të tjera si dhe të hyra në pajtim me ligjin.

Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjeksisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.

Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.

Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; web : www.oftk-ks.org

**Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës**





**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists**

Siç është e paraparë me statut, OFTK është e obliguar të raportoj në bazë të rregullt organeve të saja të larta siç është Këshilli Drejtues dhe Kuvendi.

QËLLIMI I KONTRATËS DHE REZULTATET E PRITURA

2.1 Objektiva e përgjithshme

Objektiva e përgjithshme është të prodhoj një raport të auditimit të pasqyrave financiare të Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës.

2.2 Objektiva specifike

Auditimi duhet të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)

2.3 Rezultatet e pritura

Një raport i plotë pritet në fund të angazhimit i cili do të përmbajë:

Raportin e auditimit me opinion të auditorit të pavarur ,
Letrën e menaxhmentit që përbëhet nga rekomandimet për ndryshimet nëse është e nevojshme në praktikat dhe procedurat për të përmbushur mangësitë.

LOGJISTIKA DHE KOHA

Angazhimi për auditim siç kërkohet do të ndërmerret në selinë e OFTK në Prishtinë / Kosovë.

Angazhimi për auditim planifikohet të filloj me **11.06.2026** dhe do të përfundoj më **23.06.2026**

KËRKESAT

Ftohen aplikues nga firmat e auditimit ose auditorët ligjor të cilët përmbushin kriteret në vijim.





Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova Kosovo Chamber of Physiotherapists

- Të jetë auditor/e ligjor dhe të mbajë certifikatë të vlefshme të praktikës të lëshuar nga KKRF.
- Kanë përvojë domethënëse në auditim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (SNK)
- Të ketë së paku tri (3) vite përvojë në auditimin e pasqyrave financiare të OJQ-ve

RAPORTIMI

Auditori do të diskutoj me Kryetarin dhe me Këshillin Drejtues të OFTK gjetjet paraprake dhe propozimet në një takim para dorëzimit të raportit final. Në këtë takim auditori do të:

- Të prezantoj draft raportin e auditimit
- Të prezantoj draft letrën e menaxhmentit
- Nënvizoj problemet e ballafaquara
- Rekomandoj zgjidhjet e mundshme në letrën e menaxhmentit

Kryetari i OFTK dhe Këshilli Drejtues do të komentojnë në mënyrë të shkruar draft raportin final brenda 2 ditësh pas pranimit të raportit. Auditori do të përfshijë komentet në raportin final brenda 2 ditësh pasi janë pranuar nga Kryetari i OFTK dhe Këshilli Drejtues.

Raporti final (duke përfshirë opinion e nënshkruar) në 3 kopje dhe një version elektronik përfshirë të gjitha konkludimet dhe rekomandimet do t'i dorëzohet OFTK me se largu deri me datën 01.07.2026.

Raportet do të dorëzohen në gjuhën shqipe.

Kontrata përfundon me plotësimin-dorëzimin e të gjitha materialeve.

Ofertuesit e interesuar, së bashku me ofertën duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë si në vijim:





**Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës / Komora Fizioterapeuta Kosova
Kosovo Chamber of Physiotherapists**

- Certifikata e regjistrimit të biznesit;
- Certifikata e regjistrimit fiskal;
- Licenca/ certifikatë nga organet kompetente për kryerjen e punëve;
- Referenca mbi kryerjen e punëve të ngjashme;
- CV-të e auditorëve që do të bëjnë auditimin.
- Oferta duhet të përmbajë:
- Planin gjeneral të auditimit;
- Afatin kohor të propozuar;
- Kërkesa për dokumentacionet që duhen të përgatiten paraprakisht nga ana e OJQ-së;
- Tarifat për auditorë;
- Shumën totale të auditimit.

Ofertat duhen të dërgohen ne email adresën: info@oftk-ks.org ose ne zarf ne selin e OFTK-së Kompleksi i QKUK, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim, Kati I, Prishtinë, Kosovë.

Ftesë për ofertim:

Auditimi i Pasqyrave Financiare (burimi dhe përdorimi i mjeteve)

Me respekt,
OFTK



Adresa: Kompleksi i Q.K.U.K, Klinika e Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim, Kati i I-rë, RKS-10000.
Address: UCCK Complex, Physical Medicine Clinic with Rehabilitation, 1st Floor, RKS-10000.
Tel +383(0) 45 460 551; e-mail info@oftk-ks.org; web : www.oftk-ks.org

**Oda e
Fizioterapeutëve
të Kosovës**

